


TaxNews

Janar 2019
January 2019



Deloitte.

I. Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.12.2018, i publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 189, datë 28.12.2018, në fuqi nga data 01.01.2019, ka përcaktuar pagën e re minimale në shkallë vendi në nivelin 26,000 Lekë/muaj (*më parë, e barabartë me 24,000 Lekë*), që i korrespondon orëve normale të punës prej 174 orë/muaj. Rrjedhimisht, paga minimale orare është përcaktuar në 149 Lekë/orë (*më parë, e barabartë me 138 Lekë/orë*).

Paga minimale në shkallë vendi prej 26,000 Lekë do të shërbejë si paga e re minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore duke filluar nga muaji janar 2019. Njëkohësisht, siç ka njoftuar edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, edhe paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore do të ndryshojë me efekt nga muaji janar 2019 duke u rritur në 114,670 Lekë (*më parë, e barabartë me 105,850 Lekë*).

II. Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre"

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019, i publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 18.01.2019, përcakton se cilat shoqëri do të konsiderohen me 'interes publik' për nga natyra e biznesit, madhësia apo numri i punonjësve.

I. Decision of the Council of Ministers "On determining the national minimum wage"

Decision of the Council of Ministers no. 809, dated 26.12.2018, published in the Official Gazette no. 189, dated 28.12.2018, entering into force on 01.01.2019, has determined the new national minimum wage at ALL 26,000/month (*previously, it was equal to ALL 24,000*) corresponding to the normal 174 hours/month. Consequently, the minimum hourly wage has been determined at the level of ALL 149/hour (*previously, it was equal to ALL 138/hour*).

The minimum wage of ALL 26,000 will serve as the new minimum wage for the calculation of social and health insurance contributions starting from January 2019. At the same time, as announced by the General Tax Directorate, the maximum wage for calculating social security contributions will also change with effect from January 2019, increasing to ALL 114,670 (*previously, it was equal to ALL 105,850*).

II. Decision of the Council of Ministers "On the definition of other state or private companies, important to the public interest due to the nature of the business, company size or number of employees"

Decision of the Council of Ministers no. 17, dated 16.01.2019, published in the Official Gazette no. 4, dated 18.01.2019 determines which companies will be considered of 'public interest' due to the business nature, company size or number of employees.

Ky Vendim vjen në vijim të ndryshimeve të vitit 2016 në Ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (lutemi referojuni Tax News-it tonë të majit 2016) si edhe me hyrjen në fuqi nga data 01.01.2019 të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (lutemi referojuni Special Tax News-it tonë të majit 2018). Këto dy ligje sollën si risi edhe statusin e 'njësive ekonomike me interes publik' duke përcaktuar që këto njësi do të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit e raportimit financiar (SNK/SNRF) dhe do të jenë subjekt i auditimit ligjor të pasqyrave financiare.

Kështu, në bazë të këtij Vendimi:

● **Shoqëri 'me interes publik' për nga natyra e biznesit** do të konsiderohen ato shoqëri shtetërore ose private:

- a. Në të cilat shteti ka pjesëmarrje në kapital; ose
- b. Që kanë më shumë se 50% të të ardhurave nga fondet publike; ose
- c. Që operojnë si degë, shoqëria mëmë e të cilave është e listuar në bursë; ose
- d. Të cilat ofrojnë një të mirë publike në aktivitetin e tyre tregtar dhe janë subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse.

● **Shoqëri 'me interes publik' për nga madhësia e biznesit** do të konsiderohen ato shoqëri shtetërore ose private që:

- a. Vlerën e totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në periudhën kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 1.5 miliardë Lekë*; ose
- b. Vlerën e totalit të aktiveve të bilancit në fund të periudhës kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 750 milionë Lekë*;

This Decision follows the amendments introduced in 2016 to Law no. 10 091, dated 05.03.2009, "On statutory audit and organisation of professions of registered accounting expert and approved accountant" (please refer to our Tax News of May 2016) as well as the entry into force from 01.01.2019 of the Law no. 25/2018 "On accounting and financial statements" (please refer to our Special Tax News of May 2018). Both laws introduced the status of 'public interest entities' by specifying that these entities shall apply the international accounting and financial reporting standards (IAS/IFRS) and shall be subject to statutory audit on their financial statements.

Therefore, based on this Decision:

● **Companies of 'public interest' due to the nature of business** will be considered those private or state-owned companies:

- a. In which the state participates in capital; or
- b. With more than 50% of revenue from public funds; or
- c. That operate as a branch whose parent company is listed in a stock exchange; or
- d. That provide a public good through their commercial activity and are subject of regulators of the respective fields.

● **Companies of 'public interest' due to the size of business** will be considered those private or state-owned companies with:

- a. A total amount of revenue from the economic activity (turnover) in the accounting period equal to or higher than ALL 1.5 billion*; or
- b. A total amount of assets in the statement of financial position at the end of the accounting period equal to or higher than ALL 750 million*.

**Kur njësia bie nën këto vlera, duhet që kjo të ndodhë për dy periudha kontabël radhazi në mënyrë që të çenohet klasifikimi si 'me interes publik'.*

- **Shoqëri 'me interes publik' për nga numri i punëmarrësve** do të konsiderohen ato shoqëri shtetërore ose private që:

- a. Në fund të periudhës kontabël kanë më shumë se 250 punonjës; ose
- b. Për të gjithë periudhën kontabël, kanë një numër mesatar punonjësish më të madh se 250.

III. Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e aktiviteteve që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, si dhe procedurat për aplikimin e tatimit nga personat juridikë që ushtrojnë këto aktivitete"

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 12.12.2018, i publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 13.12.2018, përcakton aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve dhe procedurat për aplikimin e normës së reduktuar të tatimit mbi fitimin prej 5% nga personat juridikë që ushtrojnë këto aktivitete. Ky Vendim vjen në zbatim të ndryshimeve të sjella nga Paketa Fiskale 2018 në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me efekt nga 01.01.2018 (lutemi referojuni Special Tax News-it tone mbi Paketën Fiskale 2018).

Aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve

Shkalla tatimore prej 5% do të zbatohet nga personat juridikë të cilët kanë si qëllim të aktivitetit të tyre:

**When the entity does not exceed these values, this should occur for two consecutive accounting periods in order for it to no longer classify as 'public interest entity'.*

- **Companies of 'public interest' due to the number of employees** shall be considered those private or state-owned companies that:

- a. At the end of the accounting period have more than 250 employees; or
- b. Throughout the accounting period, have an average number of employees higher than 250.

III. Decision of the Council of Ministers "On the definition of activities included in the field of software production/development as well as the procedures for the application of profit tax by legal persons carrying out these activities"

Decision of the Council of Ministers no. 730, dated 12.12.2018, published in the Official Gazette no. 176, dated 13.12.2018, defines the eligible activities included in the field of software production/development and the procedures for applying the reduced rate of corporate income tax/profit tax of 5% by legal persons carrying out such activities. This Decision comes into application following the amendments introduced by Fiscal Package 2018 to Law no. 8438, dated 28.12.1998 "On income tax", with effect from 01.01.2018 (please refer to our Special Tax News on the Fiscal Package 2018).

Activities included in the software production/development area

The reduced tax rate of 5% for profit tax purposes will apply to legal persons that have as purpose of their activity:

- a. Dizenjim software-i;
- b. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software;
- c. Testim software-i;
- d. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit;
- e. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë;
- f. Zhvillim sistemesh migrimi;
- g. Përmirësim sistemesh informatike;
- h. Operim, manaxhim, suport përdorimi, trajnim dhe auditim teknik/informatik për sistemet software.

Procedurat për aplikimin e tatimit mbi fitimin prej 5%

Në mënyrë që të aplikojnë shkallën tatimore 5%, personat juridikë duhet:

- a. Të kenë në objektin e veprimtarisë vetëm aktivitete të teknologjisë së informacionit që lidhen me hardware dhe software;
- b. Të kenë përcaktuar si objekt veprimtarie në statutin e shoqërisë, ndër të tjera, dhe aktivitete nga lista e mësipërme;
- c. Të paraqesin një deklaratë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse mbi aktivitetin/et për të cilët do të zbatojnë shkallën 5% si dhe mbi listën e punonjësve të dedikuar këtyre aktiviteteve.

Shkalla tatimore prej 5% aplikohet vetëm për pjesën e aktiviteteve të listuara më lart.

- a. Software design;
- b. Development and maintenance of software systems;
- c. Software testing;
- d. Design and development of communication systems;
- e. Design and development of security systems;
- f. Development of migration systems;
- g. Upgrade of IT systems;
- h. Operation, management, user support, training and technical/informatics audit of software systems.

Procedures for the application of the profit tax of 5%

In order to apply the reduced 5% rate, such legal persons should:

- a. Have as object of activity only information technology activities related to hardware and software;
- b. Have determined as the object of activity in the statute of the company also the activities included in the above list;
- c. Submit a written statement to the relevant Regional Tax Directorate for the activity/ies for which the 5% rate will apply as well as the list of employees dedicated to such activities.

The reduced tax rate of 5% applies only to the part of activities listed above.

Personat juridikë, të cilët përveç veprimtarisë ekonomike në fushën e teknologjisë së informacionit kryejnë edhe veprimtari të tjera ekonomike, duhet të ndajnë me NIPT/NUIS-e të veçanta veprimtarinë në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të jenë në gjendje të aplikojnë shkallën e tatimit mbi fitimin prej 5% për aktivitetet e listuara më lart.

Personat juridikë që zbatojnë shkallën tatimore prej 5%, ndër të tjera, duhet të prezantojnë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare informacione specifike mbi të ardhurat, shpenzimet, kostot e punës së punonjësve, shpenzimet operative dhe kostot e shërbimit që lidhen me aktivitetet me shkallë tatimore 5%.

IV. Shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në""

Shtesat dhe ndryshimet në Vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1, datë 11.01.2019, reflektojnë disa prej ndryshimeve të sjella në Ligjin "Për TVSH-në" nga Paketa Fiskale 2019 (lutemi referojuni Special Tax News-it tonë mbi Paketën Fiskale 2019). Ndër të tjera, ky Vendim përcakton:

- Listën e inputeve bujqësore (plehurat kimikë, pesticidet, farat dhe fidanët) të përjashtuar nga TVSH, si dhe
- Listën e lëndëve të para për prodhimin e barnave importimi i të cilave është i përjashtuar nga TVSH.

Legal persons that perform other economic activities besides the economic activity in the area of information technology should register a separate NIPT/NUIS for the activity in the area of information technology in order to apply the reduced tax rate of 5% for the activities listed above.

Legal persons that apply the reduced tax rate of 5%, among other things, must present in the respective notes to the financial statements specific information on revenue, expenses, employee costs, operating expenses and service costs related to activities subject of the reduced tax rate of 5%.

IV. Additions and amendments to the Decision of Council of Ministers "On the implementin provisions of the Law no. 92/2014 "On VAT""

Additions and changes in the Decision no. 953, dated 29.12.2014, published in the Official Gazette no. 1, dated 11.01.2019, reflect some of the amendments to the Law "On VAT" brought by the Fiscal Package 2019 (please refer to our Special Tax News on the Fiscal Package 2019). Among other things, this Decision determines:

- The list of agricultural inputs (chemical fertilizers, pesticides, seeds and saplings) exempt from VAT, as well as
- The list of raw materials for the production of drugs exempt from VAT on import.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 264,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.